

1 E hënë, 5 tetor 2020

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 15.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: Mirëdita të gjithëve brenda dhe jashtë  
7 sallës së gjyqit.

8 Lus sekretaren e Gjykatës të paraqesë lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: Mirëdita i nderuar Gjykatës. Lënda  
10 KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja Sekretare e Gjykatës.

12 Tani, do t'ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve të  
13 prezantohen. Do të filloj me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

14 Urdhëroni z. Prokuror.

15 Z. CARNEY: Unë jam Andrew Carney, prokuror. Me mua nga Zyra  
16 e Prokurorit të Specializuar është Silvia D'ascoli,  
17 ndihmësprokurore; Clare Lawson, shefe e Zyrës Juridike dhe Aniko  
18 Boldog që është ndihmës i Administrimit të Çështjes dhe të  
19 Provave.

20 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Prokuror.

21 Tani radhën e ka Mbrojtja.

22 Z. VON BONE: Mirëdita i nderuar Gjykatës. Mirëdita zonja  
23 dhe zotërinj. Unë jam Julius von Bone, dhe jam avokati mbrojtës i  
24 z. Mustafa. Ju faleminderit

25 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Von Bone. Për hir të

1 procesverbalit theksoj se në sallë është i pranishëm edhe klienti  
2 juaj, z. Mustafa.

3 Tani fjalën e ka Zyra Administrative.

4 Z. ROCHE: Mirëdita. Unë jam shefi i Shërbimit Gjyqësor  
5 Ralph Roche.

6 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

7 Unë jam gjykatës Nicolas Guillou, gjykatës i Procedurës  
8 Paraprake në këtë çështje.

9 Më 30 shtator, caktova mbajtjen e Konferencës për Ecurinë e  
10 Çështjes për sot, e hënë. Kërkova nga palët që të paraqesin  
11 parashtrimet lidhur me pikat e përfshira në rendin e ditës, që i  
12 bashkëlidhet urdhrit. Të dy palët, Mbrojtja dhe ZPS-ja  
13 parashtruan komentet e tyre sot në mëngjes.

14 Qëllimi i kësaj seancë është që të shikohet, të shqyrtohet  
15 ecuria e çështjes dhe të organizohet shkëmbim midis palëve. Në  
16 veçanti, dëshiroj që të diskutoj ecurinë e hetimeve që kryejnë  
17 palët dhe sasinë e përafërt të provave shkresore dhe dëshmive që  
18 do të paraqesin palët në gjykim, materialet shtesë që do të  
19 përdoren gjatë gjykimit, materialin mbështetës të aktakuzës,  
20 provat shfajësuese dhe materialin mbrojtës, dhe së fundi çfarëdo  
21 pike tjetër që duan të ngrenë palët.

22 E di që Mbrojtja propozon të diskutohet një praktikë e  
23 veprimit që duhet të përcaktohet për rastet kur të dy palët  
24 kontaktojnë të njëjtin dëshmitar. Dhe këtë mund ta diskutojmë më  
25 vonë, pasi t'i kemi diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës,

1 Z. Von Bone.

2 Gjithashtu dua të bëj edhe komente lidhur me dokumentet që  
3 tashmë janë dorëzuar në seancë të mbyllur, thotë Mbrojtja. Ftoj  
4 mbrojtësin që këtë të ma bëjë të ditur pra, kur duhet të kalojmë  
5 në seancë private për diskutimin e këtyre materialeve.

6 Tani dua që t'i informoj palët, sidomos Mbrojtjen, që  
7 versioni i redaktuar i vendimit të konfirmimit do t'ju bëhet i  
8 ditur palëve -- dhe Mbrojtjes dhe publikut nesër më së voni.

9 Në këtë drejtim, dua të informoj Mbrojtjen, se në vendimin e  
10 konfirmimit, kam caktuar një afat prej dy javësh nga Paraqitja e  
11 Parë, për Zyrën e Prokurorit të Specializuar që të dorëzojë  
12 çfarëdo kërkesë të mundshme për masa të mbrojtjes lidhur me  
13 materialin mbështetës.

14 Tani ftoj palët që të ndjekin rendin e ditës për këtë  
15 Konferencë të sotme.

16 Përpara se t'ju jap fjalën palëve, dua që t'ju përkujtoj të  
17 gjithëve parimet e përgjithshme të nxjerrjes së materialeve në  
18 kuadrin ligjor të Dhomave të Specializuara.

19 Dorëzimi apo nxjerrja e materialeve është një proces i  
20 shkëmbimit të materialeve midis palëve në formë elektronike, që  
21 organizohet dhe mundësohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të  
22 dokumentacionit gjyqësor të Zyrës Administrative.

23 Zbardhja apo nxjerrja e materialeve duhet të jetë prioritet  
24 për Prokurorinë në këtë fazë, dhe palët duhet të nxjerrin provat  
25 që janë të rëndësishme për çështjen.

1 Duke marrë parasysh parimin e publicitetit provat nxirren  
2 dhe bëhen publike, përveçse në qoftë se i nënshtrohen ndonjë  
3 urdhri për masa mbrojtëse.

4 Urdhëroni z. Prokuror.

5 Z. CARNEY: Ju me siguri i nderuar Gjykatës, keni një kopje  
6 të parashtrimeve të Prokurorisë për këtë Konferencë, të cilat u  
7 dorëzuan sot në mëngjes për protokollim.

8 I nderuar Gjykatës, për sa i përket pyetjeve të  
9 përgjithshme, ju me siguri jeni të vetëdijshëm që mbeten edhe më  
10 tutje disa hetimorë që duhet të kryejë Prokuroria. Si rezultat i  
11 kësaj ekziston një gjasë që në të ardhmet të nxirren edhe prova  
12 të tjera.

13 Gjithsesi, Zyra e Prokurorit të Specializuar, në këtë fazë,  
14 nuk parashikon që kjo të ketë ndikim në kryerjen e shpejtë të  
15 procedurave dhe sigurisht që këto hapa hetimorë të mbetur do të  
16 përfshihen në fazën fillestare të kësaj procedure paraprake.

17 Për sa i përket volumit të çështjes në përgjithësi, Zyra e  
18 Prokurorit të Specializuar në këtë fazë mbështetet në pesë  
19 dëshmitarë, për qëllimet e aktakuzës së konfirmuar, dhe ka  
20 ndërmend që të mbështetet në këta pesë dëshmitarë edhe gjatë  
21 gjykimit. Prokuroria parashikon që kësaj liste t'i shtojë edhe 11  
22 dëshmitarë të tjerë pra, listës së dëshmitarëve, edhe pse ky  
23 numër mund të ndryshojë varësisht nga rezultati i hapave hetimorë  
24 të mbetur.

25 Atë që mund ta them në këtë fazë është se Prokuroria

1 sigurisht do të thërrasë 16 dëshmitarë, ose edhe më shumë, por  
2 siç thashë, nuk mund të parashikoj që mund të ketë edhe më shumë  
3 në këtë fazë.

4 Përveç kësaj Zyra e Prokurorit të Specializuar do të  
5 paraqesë prova shkresore si p.sh., raporte, fotografi, dokumente  
6 të UÇK-së të asaj kohe, si p.sh., urdhra dhe rregullore, si dhe  
7 publikime të tjera.

8 Në këtë fazë mund të them se kjo është përgjigjja jonë në  
9 pyetjet e përgjithshme, dhe besoj se që kjo do t'i ndihmojë si  
10 Gjykatën ashtu edhe Mbrojtjen për sa i përket çështjes së  
11 Prokurorisë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Prokuror.

13 Tani i drejtohem mbrojtësit. Z. Von Bone, a keni koment  
14 lidhur me atë që tha prokurori në këtë moment, apo ndoshta doni  
15 edhe që edhe ju të intervenoni në këtë fazë.

16 Z. VON BONE: Ju faleminderit i nderuar Gjykatës.

17 Përveç parashtrimeve të sotme të Prokurorisë, unë kam parë  
18 edhe sistemin e redaktimit që ka parashtruar Prokuroria si edhe  
19 komentet lidhur me gjuhën e punës. Nuk kam komente shtesë, përveç  
20 atyre që i kam paraqitur në parashtrimin tim me shkrim lidhur me  
21 këto dy pika.

22 Për sa i përket fazës së hetimit apo numrit të dëshmitarëve,  
23 apo sasisë së materialeve shkresore, në këtë moment nuk mund të  
24 them asnjë gjë përfundimtare. Me siguri që do të ketë hetime, me  
25 siguri që do të ketë dëshmitarë, me siguri që do të ketë

1 dokumentacion shkresor; por sasia e të gjithë këtyre materialeve  
2 mbetet të shihet.

3 Të jemi të qartë, çfarëdo që të jenë këto materiale do të  
4 jenë në lidhje me çështjen dhe nuk do të jenë të natyrës së  
5 përgjithshme.

6 Kaq kisha për të komentuar.

7 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Von Bone.

8 Në këtë fazë, a keni për të thënë ndonjë gjë lidhur me  
9 hetimet e mundshme që -- doni të bëni si Mbrojtje, apo është  
10 shumë herët për këtë?

11 Z. VON BONE: Mendoj që është herët i nderuar Gjykatës.  
12 Vërejtja që në parashtrimet e Prokurorisë përmenden provat  
13 shfajësuese. Nuk jam 100 për qind i sigurt në qoftë se është  
14 fjala për materialin e dorëzuar numër 3 apo 4. Pra, nuk jam 100  
15 për qind i sigurt, ndoshta flitet për ndonjë dorëzim që do të  
16 bëhet më tej i materialeve.

17 Unë kam materialet 2, 3 dhe 4 që janë dorëzuar pra, tufat e  
18 materialeve 2, 3 dhe 4.

19 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit z. Von Bone.

20 Z. Prokuror, a keni ju diçka tjetër për të shtuar,  
21 konkretisht, lidhur me tufat e materialeve që janë dorëzuar?

22 Z. CARNEY: Po. Dorëzimi 1 është në fakt, dorëzimi i  
23 materialit në mbështetje të parashtrimit që jua kemi dorëzuar ju  
24 z. Gjykatës.

25 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

1 A e sqaron kjo atë që deshët të dinit z. Von Bone?

2 Z. VON BONE: Jo. Parashtrimi për çfarë? Nuk kam parë  
3 nxjerrje materialesh për sa i përket materialit provues në këtë  
4 kuptim. Për çfarë bëhet fjalë? Përmendja e provave bazë në  
5 mbështetje të aktakuzës, a për këtë e ka fjalën prokurori?

6 GJYKATËSI GUILLOU: Z. Prokuror.

7 Z. CARNEY: Po i nderuar Gjykatës. Për qartësim, Mbrojtja do  
8 të marrë së shpejti një tufë të re dokumentesh në mbështetje të  
9 parashtrimit të aktakuzës.

10 GJYKATËSI GUILLOU: D.m.th., kjo do të jetë tufa e parë që e  
11 përmendi zoti Avokat i Mbrojtjes?

12 Z. CARNEY: Po.

13 GJYKATËSI GUILLOU: Mendoj z. Von Bone që me këtë edhe  
14 sqarohet pika që se kishit të qartë.

15 Tani të kaloj te pika e dytë e rendit të ditës të kësaj  
16 Konference, që është materiali mbështetës i aktakuzës.

17 Dua të përkujtoj Prokurorin e Specializuar që brenda 30  
18 ditësh nga Paraqitja e Parë, i gjithë materiali mbështetës ndaj  
19 aktakuzës dhe të gjitha deklaratat e të akuzuarit duhet t'i  
20 dorëzohen Mbrojtjes.

21 Tani ftoj ZPS-në që të bëjë parashtrimet e veta lidhur me  
22 nxjerrjen e këtij materiali pra, materialin mbështetës të  
23 aktakuzës.

24 Z. CARNEY: I nderuar Gjykatës, për sa i përket këtij  
25 materiali, në fakt Mbrojtja ka marrë deri tani dy tufa

1 dokumentesh pra, të këtij materiali. Këto janë dorëzimet 2 dhe 3  
2 të materialeve. Në thelb materialet e mbetura d.m.th., që nuk  
3 janë përfshirë në këto dorëzime, janë materiale që lidhen me  
4 dëshmitarë pra, deklarata dhe dëshmi.

5 Tufa e parë e dokumenteve pra, dorëzimi i parë që ka marrë  
6 Mbrojtja deri tani, kryesisht përfshin dokumentacion që nuk  
7 lidhet me dëshmitarë dhe që është në mbështetje të aktakuzës.

8 Materiali i mbetur mbështetës që nuk i është dorëzuar deri  
9 tani Mbrojtjes, ka të bëjë me pesë dëshmitarët që i përmenda edhe  
10 më herët, mbi të cilët edhe është mbështetur ZPS-ja për qëllimet  
11 e konfirmimit të aktakuzës. Dhe këto materiale do të jenë objekt  
12 i kërkesës së parë të Prokurorit të Specializuar për masa  
13 mbrojtëse. Dhe kjo kërkesë për masat mbrojtëse, sikurse  
14 parashikohet, do të bëhet brenda dy javësh nga Paraqitja e Parë e  
15 të të akuzuarit, sikurse është urdhëruar edhe më herët.

16 Materiali mbështetës që lidhet me dëshmitarët, në përputhje  
17 me vendimet e mëparshme të Gjykatësit, duhet të redaktohet. Pra,  
18 në kuptim të informacionit që mund të çojë në identifikimin e  
19 dëshmitarëve dhe viktimave, -- pra, krahas redaktimeve të  
20 informacioneve të tjera që bien brenda kategorive të  
21 identifikimit të informacionit.

22 Këto redaktime janë në përfundim e sipër, dhe Zyra e  
23 Prokurorit pret që të jetë e gatshme të bëjë nxjerrjen e  
24 versioneve të redaktuara të materialeve të mbetura mbështetëse  
25 brenda dy javëve që vijnë, ose në çdo rast, brenda afatit 30



1 ditësh të paraparë me Rregullore.

2 Gjithashtu, dua të theksoj që për sa i përket materialit në  
3 fjalë, që përfshin deklaratat të dëshmitarëve dhe transkripte, e  
4 dini që ekziston puna e përkthimit të tyre në shqip, dhe kjo punë  
5 është pothuajse e përfunduar dhe këto përkthime do t'i dorëzohen  
6 palës tjetër brenda 30 ditësh.

7 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit i nderuar -- Prokuror.

8 A keni diçka për të shtuar z. Von Bone, lidhur me këtë  
9 material mbështetës?

10 Z. VON BONE: Po, i nderuar Gjykatës, ajo që kam parë në  
11 materialet që më janë dorëzuar në lidhje me deklaratat e klientit  
12 tim, aty përmendet shpesh një libër i shkruar nga një autor i  
13 caktuar, dhe unë nuk e kam parë këtë libër dhe nuk e di nëse ky  
14 libër do të më jepet, apo do të jetë pjesë e provave.

15 Është e rëndësishme ta them këtë në këtë fazë, sepse kur e  
16 kanë pyetur -- ata klientin tim, ka pasur disa pjesë ku janë bërë  
17 citime të drejtpërdrejta të atij libri, dhe tani këto citime  
18 duhet t'i fusim në kontekst dhe ne duhet të dimë burimin e këtyre  
19 citimeve. Dhe është e rëndësishme për ne të dimë, dhe të na e  
20 thotë prokurori, nëse ka ndërmend të na e japë këtë libër dhe ta  
21 përdorë atë si provë materiale.

22 Unë mendoj që kjo është e rëndësishme për Gjykatën, për të  
23 kontrolluar dhe për të vënë në provë atë që, a mund ne të  
24 shikojmë kontekstin e duhur të citimeve që janë bërë dhe që t'i  
25 japim përgjigje të duhur atyre.

1 Ky është vëzhgimi im dhe kjo është pyetja që ia bëj

2 Prokurorisë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

4 A është e mundshme të bëhet kjo brenda 30 ditëve?

5 Z. CARNEY: I nderuar Gjykatës, unë mendoj që ky libër që  
6 përmend Mbrojtja, nuk është i përfshirë në materialet mbështetëse  
7 të aktakuzës, megjithatë, ai do të bëjë pjesë në provat që do të  
8 paraqiten në këtë çështje, kështu që ata do ta marrin këtë  
9 material.

10 GJYKATËSI GUILLOU: A është e mundur që Mbrojtja ta marri  
11 këtë para afatit 30-ditor?

12 Z. CARNEY: Po.

13 GJYKATËSI GUILLOU: Z. Von Bone, jeni i kënaqur me këtë  
14 përgjigje?

15 Z. VON BONE: Unë mendoja që ky libër ishte në shqip, siç e  
16 shikoj këtu nga transkripti, ka pasur pjesë të tij që janë  
17 përkthyer. A do të jetë ky libër i tëri në anglisht dhe -- do të  
18 jetë në anglisht si pjesë e provave, dhe nëse nuk ekziston  
19 përkthimi, a mund të bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara?

20 Z. CARNEY: Po. Ky tekst është një tekst në shqip dhe një  
21 pjesë e madhe e tij është përkthyer në anglisht, dhe pjesa që nuk  
22 është përkthyer do ta -- shikojmë sesa ka mbetur për t'u  
23 përkthyer, dhe sigurisht që do t'ia dorëzojmë Mbrojtjes. Por  
24 përsëri e them, që ato pjesët që janë përmendur në transkriptin e  
25 intervistës së të të akuzuarit janë të përkthyer dhe mund t'i

1 jepen të akuzuarit.

2 GJYKATËSI GUILLLOU: Faleminderit.

3 Z. VON BONE: Po kjo nuk i përgjigjet plotësisht pyetjes  
4 sonë. Në qoftë se -- janë përkthyer disa citime, disa pjesë të  
5 saj, dhe unë dua të shikoj, t'i vë ato në kontekst. Të shoh  
6 p.sh., cili kapitull, çfarë poshtëshënimesh ka apo çfarë burimesh  
7 janë përdorur.

8 Kjo duket sikur i janë bërë pyetje klientit tim dhe ai e ka  
9 shpjeguar atë në një mënyrë të ndryshme, prandaj edhe është e  
10 rëndësishme që të kemi kapitujt. Ndoshta -- mund të mos jetë e  
11 rëndësishme që të kemi të gjithë librin, por në qoftë se citohet  
12 diçka nga ai libër, të paktën të kemi kapitullin për të parë  
13 kontekstin, duke qenë në gjendje kështu të përcaktojmë që kjo  
14 është thënë edhe ky ka qenë konteksti, dhe të jemi në gjendje të  
15 themi që ky prokuror e ka nxjerr këtë citim të caktuar dhe ia ka  
16 paraqitur klientit tim.

17 Dhe disa herë e kam parë klientin tim që ka thënë që, po ai  
18 ndoshta ka dashur të thotë diçka tjetër, apo ndoshta ai person i  
19 caktuar e përshkruan një vend të caktuar krejt ndryshe.

20 Pra, të gjitha këto janë shqetësime që janë të rëndësishme  
21 dhe prandaj them që Prokuroria duhet t'i vërë gjërat në kontekst.

22 Dhe reagimi i klientit tim dhe -- pika e përqendrimit nga  
23 Prokuroria, prandaj është shumë e rëndësishme që Mbrojta ta marri  
24 këtë material në kontekstin e duhur në mënyrë që të përcaktohen  
25 faktet ashtu siç duhet për gjërat që i akuzuari ka thënë dhe për

1 të cilat ka komentuar.

2 GJYKATËSI GUILLOU: Nuk mendoj që i gjithë libri mund të  
3 quhet si material mbështetës për aktakuzën. Mund të jenë disa  
4 pjesë që janë përdorur dhe këto duhen përkthyer. Po mbas kësaj,  
5 nuk mendoj se duhet përkthyer i gjithë libri në anglisht.

6 Pra, duhet të vendosim një balancë midis -- faqeve që janë  
7 të rëndësishme për çështjen. Dhe gjithashtu, duhet të kemi  
8 parasysh edhe aftësitë përkthyesë të Zyrës së Prokurorit të  
9 Specializuar, sa njerëz ka për t'i përkthyer ato.

10 Por sidoqoftë, mendoj që për sqarime të mëtejshme, ne duhet  
11 t'i marrim të gjitha këto parasysh si material mbështetës të  
12 aktakuzës sipas rregullës 102(1)(a).

13 Z. VON BONE: Edhe një koment për këtë. Në materialin  
14 mbështetës që kam marrë deri tani, ka një ndarje të UÇK-së si të  
15 thuash, dhe nuk e di cili është burimi i kësaj dhe nga ka ardhur.  
16 Kjo ka ardhur nga ai libër apo jo. Me sa di unë, këtë libër e ka  
17 shkruar një historian. Ndoshta ky person mund vijë të japë dëshmi  
18 apo jo. Nuk e dimë në këtë fazë.

19 Megjithatë, mendoj që është e rëndësishme të dimë se cili  
20 është burimi i këtij libri dhe këto ndarje të organeve të UÇK-së  
21 që ka bërë ai.

22 GJYKATËSI GUILLOU: Z. Prokuror, keni diçka tjetër për të  
23 shtuar në lidhje me këtë temë përpara se të vazhdojmë më tej?

24 Z. CARNEY: Po. Tema tjetër lidhet me materialet që janë  
25 materiale shtesë që do të përdoren në gjykim.

1 GJYKATËSI GUILLOU: Jo, z. Prokuror. Për pyetjen që ngriti  
2 Z. Von Bone d.m.th., kjo çështje specifike që ngriti ai. A keni  
3 ju një organigram të UÇK-së, sepse z. Von Bone mendon që është ky  
4 libri, ai burimi i këtij organigrami.

5 Z. CARNEY: Po. Origjina e këtij dokumenti do të trajtohet  
6 në meta të dhënat. Megjithatë, në qoftë se do të ketë vështirësi  
7 për Mbrojtjen, atëherë ne do ta diskutojmë me njëri-tjetrin këtë  
8 çështje sesi ta zgjidhim.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Z. Von Bone, a mund të vazhdojmë në  
10 pikën tjetër të rendit të ditës?

11 Z. VON BONE: Po.

12 Z. CARNEY: Po z. Gjykatës. Për sa i përket materialeve që  
13 -- përveç materialeve që përfshihen në rregullën 102(1)(a), ZPS-  
14 ja do të nxjerrë edhe materiale të tjera sipas rregullës  
15 102(1)(b).

16 ZPS-ja beson që do t'i dorëzojë këto materiale deri më 1  
17 dhjetor 2020, ose jo më vonë se 30 ditë përpara se të hapet  
18 çështja e Prokurorisë, në varësi të ndonjë mase mbrojtëse që do  
19 të jepet nga gjykatësi.

20 Materialet shtesë, sipas rregullës 102(1)(b), do të jenë  
21 deklarata dhe dëshmi të të paktën 11 dëshmitarëve, dhe  
22 transkriptimi dhe përkthimi i këtyre deklaratave dhe dëshmive  
23 mbetet një punë në vijimësi në lidhje me tetë dëshmitarë. Jemi  
24 ende duke punuar me ta. Kjo është një punë që kërkon një vëmendje  
25 shumë të madhe dhe kërkon shumë kohë për t'u shqyrtuar dhe për

1 t'u rishikuar.

2 Për sa i përket provave materiale, ZPS-ja do të paraqesë 50  
3 prova materiale në gjyq. Ky është një vlerësim paraprak dhe mund  
4 të ndryshojë në varësi të relevancës së dokumenteve që do të  
5 merren dhe rezultateve që do të kemi, si dhe hapave të mëtejshëm  
6 hetimorë.

7 Provat materiale do të përfshijnë intervista, fotografi,  
8 raporte dhe dokumente të asaj kohe, si dhe materiale në video.  
9 Materialet, sipas rregullës 102(1)(b), që lidhen me dëshmitarët;  
10 këto do të kenë nevojë për redaktime të atyre pjesëve që  
11 identifikojnë viktimat dhe dëshmitarët, në pajtim me autorizimin  
12 paraprak që keni dhënë ju z. Gjykatës dhe masave mbrojtëse që  
13 mund të jepen më vonë, përveç redaktimit të disa informacioneve  
14 që përfshihen në kategoritë e identifikuar në komentet për  
15 redaktime të ZPS-së.

16 Në lidhje me këtë, ZPS-ja do të bëjë një kërkesë të dytë për  
17 masa mbrojtëse që lidhen me tetë dëshmitarë shtesë. ZPS-ja mendon  
18 se do të jetë në gjendje të bëjë këtë kërkesë të dytë për masa  
19 mbrojtëse pasi të ketë bërë kërkesën e parë, dhe pasi të jetë  
20 diskutuar ajo në seancë gjyqësore dhe ju të keni marrë vendim.  
21 Por data që japim ne për këtë, data e fundit është 1 dhjetor  
22 2020.

23 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Prokuror.

24 Z. Von Bone, për këto materialet shtesë dhe sidomos për  
25 afatet kohore që u përmendën nga Prokurori.

1 Z. VON BONE: Për sa i përket afateve kohore, Mbrojtja është  
2 dakord me afatet kohore, çdo gjë është në rregull me to.

3 Nuk jam i sigurt nëse albumi me fotografi që mora është  
4 pjesë e kësaj pakete me materiale, e kësaj tufe materialesh që po  
5 diskutojmë tani. Nuk e di nëse ka ndonjë material të veçantë që i  
6 shpjegon, që jep shpjegime për këto fotografi që kemi parë. Sepse  
7 thjesht të japësh një numër fotografish pa asnjë gjë tjetër, se  
8 çfarë mbështetin ato fotografi, apo çfarë janë ato fotografi  
9 përveç titullit, ne s'mund të bëjmë asnjë gjë më tej me to.

10 Në lidhje me këtë, edhe diçka tjetër i nderuar Gjykatës. Kam  
11 parë në materialet që na ka dhënë Prokuroria, se ato në disa  
12 pjesë mbështeten te procesverbali i një gjykimi tjetër, që nuk do  
13 ta përmend se cili është ai gjykim, por kam parë që jo të gjitha  
14 ato -- jo i gjithë procesverbali është i përkthyer në shqip.  
15 D.m.th., i kanë zgjedhur vetëm pjesë të atij materiali nga  
16 shqipja për t'i përkthyer në anglisht. Më duket se janë vetëm dy  
17 deklarata në qoftë se nuk e kam gabim.

18 Por është shumë e rëndësishme, sigurisht që në qoftë se  
19 Prokuroria dëshiron të mbështetet në to. Dua të di nga  
20 Prokuroria, si do t'i përkthejnë ato? Sepse përndryshe do t'i  
21 bjerë që ne të mbështetemi në diçka, ose ata do të mbështeten në  
22 diçka që klienti im nuk mund të japë përgjigje.

23 GJYKATËSI GUILLOU: Z. Carney.

24 Z. CARNEY: I nderuar Gjykatës, për sa i përket fotografive.  
25 Mbrojtja ka marrë vetëm një pjesë të materialit mbështetës të

1 aktakuzës dhe do të marrë pjesën tjetër të tyre më vonë pra, do  
2 të marrin edhe materiale të tjera.

3 Dhe përveç kësaj, Mbrojtja do të marrë të gjitha materialet  
4 në varësi të rregullës 102(1)(b), dhe do të qartësohet në lidhje  
5 me materialet që ka marrë deri tani kur të marrë të gjithë  
6 paketën e plotë.

7 Për sa i përket Mbrojtjes, ata duhet ta kuptojnë që  
8 materialet që kanë marrë deri tani janë vetëm një pjesë e  
9 materialit mbështetës të aktakuzës edhe ka dhe më shumë të tjera  
10 që do të marrin më vonë.

11 Për sa i përket gjyqit të mëparshëm, gjykimit të mëparshëm  
12 që u përmend dhe procesverbalit të tij. Përsëri Mbrojtja do të  
13 marrë materialet që përfshihen në rregullën 102(1)(b), por përveç  
14 kësaj Mbrojtja do të marrë dhe materiale që bien nën nenin  
15 102(3), që janë njoftime të detajuara të provave që do ta  
16 ndihmojnë Mbrojtjen të përgatitet për çështjen e saj.

17 Pra, e përsëris përsëri, ata kanë marrë vetëm një pjesë të  
18 gjërave që do të marrin në total, por sidoqoftë e marrim shënim  
19 vërejtjen e avokatit mbrojtës dhe do t'i shikojmë këto pika në  
20 detaje.

21 Z. VON BONE: Edhe një gjë në lidhje me këtë. Pjesë të atij  
22 gjykimi ishin gjithashtu të përfshira në citimet që iu  
23 parashtruan klientit tim, dhe për këtë arsye edhe ai ka reaguuar.  
24 Për atë ne mendojmë që është me rëndësi që edhe këto pjesë të  
25 jenë të përkthyer në shqip, në mënyrë që ne të mund t'i



1 shqyrtojmë dhe të shohim se për çfarë bëhet fjalë.

2 Z. CARNEY: I nderuar Gjykatës, do të ndihmonte që pas kësaj  
3 seance Mbrojtja të na tregojë me shkrim numrat e dokumenteve që i  
4 përmend Mbrojtja, dhe në këtë mënyrë ne mund ta ndihmojmë më mirë  
5 Mbrojtjen.

6 GJYKATËSI GUILLOU: Ju falënderoj z. Prokuror. Mendoj që kjo  
7 është një ide e mirë.

8 Ky është vetëm fillimi i dorëzimit të materialeve. Siç thatë  
9 edhe ju z. Prokuror, mendoj që ju z. Von Bone, do t'i merrni  
10 dokumentet e ndryshme në tufa të ndryshme që do t'ju dorëzohen,  
11 dhe besoj që kur t'i merrni dokumentet kjo do t'i përgjigjet edhe  
12 pjesës më të madhe të pyetjeve që keni.

13 Mirëpo, gjithashtu mendoj që është me rëndësi që, sikurse  
14 tha edhe prokurori, mbrojtja duhet që t'ia tregojë numrat e  
15 materialeve që i duhen për përkthim.

16 Në qoftë se palët nuk kanë diçka tjetër për të thënë lidhur  
17 me këtë pikë, atëherë do të kalojmë te materiali provues që i  
18 duhet Mbrojtjes për përgatitjen e mbrojtjes sipas rregullës  
19 102(3).

20 Përkujtoj palët që për sa i përket kundërshtimeve në lidhje  
21 me rëndësinë e materialit, informacionit, sikurse pretendon  
22 Mbrojtja, duhen të parashtrohen menjëherë para gjykatësit të  
23 Procedurës Paraprake pra, para meje, për një vendim.

24 Marr parasysh, z. Prokuror, parashtrimin tuaj, ku thoni që  
25 parashikoni që Mbrojtjes t'i dorëzoni një njoftim të hollësishëm

1 lidhur me materialin provues deri më 1 dhjetor.

2 Keni diçka për të shtuar lidhur me këtë?

3 Z. CARNEY: I nderuar Gjykatës, zyra jonë parashikon që  
4 Mbrojtjes t'i dorëzohet njoftim i hollësishëm lidhur me  
5 materialin provues në bazë të rregullës 21 -- nenit 21(6) të  
6 Ligjit dhe rregullës 102(3) të Rregullores deri më 1 dhjetor  
7 2020, pas finalizimit të procesit të dorëzimit të materialeve që  
8 bien nën rregullën 102(1)(b).

9 Provat e përfshira në kuadër të rregullës 102(3), lidhur me  
10 to njoftimi do të jepet për informacionin e mbetur, veçanërisht  
11 materiali që duhet t'i jepet Mbrojtjes, dhe zyra jonë nuk pret që  
12 një pjesë e këtyre materialeve të duhet të redaktohet.

13 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

14 A keni diçka për të thënë ju z. Von Bone?

15 Z. VON BONE: Jo, nuk kam.

16 GJYKATËSI GUILLOU: Tani të kalojmë te pika e radhës, që  
17 është materiali shfajësues.

18 Urdhëroni z. Prokuror.

19 Z. CARNEY: Për sa i përket materialit shfajësues, në kuadër  
20 të rregullës 103, në fakt, më datën 29 shtator, ZPS-ja i dorëzoi  
21 Mbrojtjes paketën e parë të materialeve shfajësuese. Redaktimet e  
22 vetme që u zbatuan provizorisht ndaj këtij materiali, ishin  
23 redaktimet lidhur me të dhënat e kontaktit dhe emrat e mbrojtur  
24 të hetuesve.

25 I kemi thënë Mbrojtjes përafërsisht se për sa dokumente

1 bëhet fjalë. Zyra jonë për momentin po rishikon një paketë të  
2 dytë të materialit të mundshëm shfajësues.

3 Çdo material shfajësues i mundshëm që do të identifikohet në  
4 kuadër të këtij materiali, do të rishtohet dhe do të dorëzohet me  
5 redaktimet e nevojshme në qoftë se do të ketë. Zyra e Prokurorit  
6 do të vazhdojë të rishikojë të gjitha materialet që ka në  
7 posedim, nën kontroll, sipas nevojës dhe në përputhje me  
8 rregullat.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit prokuror.

10 Z. Von Bone.

11 Z. VON BONE: Materiali që u dorëzua më datën 29 shtator,  
12 ishte dorëzimi 2, 3 dhe 4. Atëherë, në qoftë se ky është i gjithë  
13 materiali shfajësues, apo materiali shfajësues i mundshëm,  
14 atëherë, dua të dëgjoj nga prokurori lidhur me këtë.

15 Nga ajo që pashë nga paketa e parë e materialit të dorëzuar,  
16 këto ishin deklarata të klientit tim. Në qoftë se këto quhen  
17 material shfajësues, atëherë, dua të di në qoftë se prokurori iu  
18 referohet edhe burimeve të tjera përveç këtyre deklaratave të  
19 klientit tim.

20 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit avokat.

21 A mund t'i përgjigjeni kësaj z. Prokuror?

22 Z. CARNEY: Po i nderuar Gjykatës.

23 Dorëzimi i materialeve 2 dhe 3, kanë të bëjnë me material  
24 mbështetës të aktakuzës. Dorëzimi 4, ka të bëjë me materialet  
25 shfajësuese. Për sa i përket materialit tjetër shfajësues që po

1 identifikohet në kryerje e sipër, ne këtë punë po e bëjmë sa më  
2 shpejt që është e mundur.

3 Ka material goxha shumë për t'u analizuar, dhe kur ta dimë  
4 për afërsisht sesa kohë do të na duhet, këtë edhe do ta themi.  
5 Mirëpo siç thashë, bëhet fjalë për goxha shumë material.

6 GJYKATËSI GUILLOU: A mund të na thoni të paktën se për  
7 çfarë lloj provash bëhet fjalë?

8 Z. CARNEY: I nderuar Gjykatës, është një shqyrtim i  
9 materialeve të ndryshme që i kemi në posedim. Ne po e bëjmë këtë  
10 shqyrtim në mënyrë që të mund të identifikohen pavarësisht nga  
11 cili burim, atë që është material shfajësues që mund ta ndihmojë  
12 Mbrojtjen, ose të minojë çështjen e Prokurorisë. Dhe ky është  
13 pikërisht qëllimi i këtij rishikimi apo shqyrtimi të  
14 dokumentacionit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit i nderuar Gjykatës --  
16 Prokuror.

17 Keni diçka për të shtuar avokat?

18 Z. VON BONE: Jo, nuk kam i nderuar Gjykatës.

19 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit.

20 Tani do të kalojmë te materiali i mbrojtur.

21 Z. Prokuror, ju e keni fjalën i pari. Duhet të keni parasysh  
22 se parashtrimet që përmendët nuk duhet të jenë problem në  
23 procesin e nxjerrjes së materialeve. Urdhëroni.

24 Z. CARNEY: I nderuar Gjykatës, për sa i përket materialit  
25 të mbrojtur, të gjitha materialet në kuadër të kësaj rregulle,

1 janë materiale që Prokuroria ka ndërmend t'i paraqesë në gjykim.

2 Në qoftë se do të ketë ndonjë ndryshim, Zyra e Prokurorit do  
3 ta informojë pa vonesë Gjykatën në qoftë se ndonjë material  
4 tjetër duhet të identifikohet dhe që është në kuadër të rregullës  
5 107, apo kufizime të rregullës 107.

6 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

7 A ka Mbrojtja diçka për të shtuar?

8 Z. VON BONE: Jo, nuk kam.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit.

10 Tani do të kalojmë te pika që ka paraqitur Mbrojtja, lidhur  
11 me përcaktimin e një praktike të veprimit në rastet kur të dy  
12 palët të kontaktojnë të njëjtin dëshmitar.

13 Urdhëroni z. Von Bone.

14 Z. VON BONE: Po, i nderuar Gjykatës.

15 E kam të qartë që hetimi i Prokurorisë ende vazhdon dhe  
16 hetimi i Mbrojtjes me të gjitha gjasat do të fillojë. Dhe gjatë  
17 kësaj është e mundur që të dy palën në një moment të kontaktojmë  
18 të njëjtin person.

19 Është me rëndësi për mendimin tim, që asnjë prej palëve  
20 pjesëmarrëse nuk mund të pretendojë monopol mbi një dëshmitar  
21 konkret, edhe pse dëshmitarët mund të jenë dëshmitarë të  
22 mbrojtur. Ne ndoshta si palë do të kontaktojmë të njëjtin person  
23 në një pikë kohore. Njëherë më ka ndodhur kjo në një gjykim  
24 tjetër. Vetëm dua të sigurohem sepse kështu gjërash mund të  
25 ndodhin, dhe për mendimin tim, në raste të tilla duhet të kemi

1 një praktikë të qartë sesi duhet të veprojmë.

2 Nga ana tjetër, ndonjëherë ndodh që raporte zbulohen nga një  
3 burim i caktuar që për momentin ndoshta nuk ka qenë i ditur, ose  
4 nga një burim që në atë moment nuk ka qenë në pozicion për t'u  
5 shprehur. Për këtë arsye mendoj që të dy palët duhet të punojnë  
6 në bazë të një besimi të mirë, mirëbesimi në njëri-tjetrin, sepse  
7 siç thashë kjo mund të ndodhë gjatë kryerjes së hetimeve.

8 Nuk e di në qoftë se në rregullat, rregulloren e kësaj  
9 gjykate ka ndonjë dispozitë lidhur me këtë praktikë veprimi.  
10 Është shumë me rëndësi që -- për të dy palët është e rëndësisë  
11 parësore mirëqenia e dëshmitarëve dhe prandaj edhe them që kjo  
12 situatë duhet të rregullohet. Duhet pra, rastet e tilla t'ia  
13 paraqesim gjykatës, apo të diskutojmë ne si palë njëra me tjetrën  
14 në mënyrë që mos të ndodhin raste të cilat mund të interpretohen  
15 si p.sh., kontaktimi i dëshmitarëve.

16 Pra, na duhet një praktikë e përcaktuar e veprimit për  
17 situata të tilla në të gjitha rastet kur është një fuqi një  
18 sistem redaktimi. Kur lexojmë materiale në format të redaktuar  
19 p.sh., mund të ndodhë që të përdorim pseudonimin e njëjtë, në  
20 mënyrë që të dihet, të jetë e qartë gjatë leximit të materialet  
21 se për çfarë bëhet fjalë.

22 Prandaj këtë edhe desha ta ngre para jush, këtë pikë i  
23 nderuar Gjykatës, në mënyrë që të jetë e qartë përpara fillimit  
24 të gjykimit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: Urdhëroni z. Prokuror.

1 Z. CARNEY: Po, i nderuar Gjykatës. Ky koment ka të bëjë me  
2 vërejtjen apo komentin që bëri Mbrojtja në lidhje me praktikën e  
3 redaktimeve. Dua të them se ZPS-ja nuk mendon se kjo do të  
4 ndikojë te praktika e redaktimit.

5 Por këto çështje që ngriti avokati mbrojtës duhen të  
6 shqyrtohen, dhe ne mund të bëjmë parashtrime apo propozime për  
7 këtë çështje në kontekstin e mocioneve që do të bëjmë për masat  
8 mbrojtëse.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Prokuror.

10 A iu përgjigj pyetjes tuaj z. Von Bone? A iu përgjigj  
11 shqetësimeve tuaja?

12 Z. VON BONE: Po, në qoftë se kjo ndodh përpara. Por  
13 personalisht nuk parashikoj në këtë fazë të procedurave që të  
14 ndodhë kjo. Por desha ta bëj të qartë që në fillim, se është në  
15 interesin e dëshmitarëve dhe të të gjitha palëve që të kemi  
16 procedurat e duhura, edhe të jemi të drejtë të dy palët me njëri-  
17 tjetrin.

18 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit avokat.

19 Atëherë, pres që palët të gjejnë një mënyrë veprimi të  
20 përbashkët në këtë çështje dhe të dy palët do të veprojnë në  
21 mënyrë të drejtë dhe të ndershme me njëri-tjetrin.

22 Në këtë pikë desha t'i pyes palët nëse kanë ndonjë çështje  
23 tjetër që duan të ngrenë. Po kështu i kujtoj palët që të na  
24 njoftojnë paraprakisht nëse ndonjë prej parashtrimeve të tyre  
25 kërkon vendosen e masave mbrojtëse.

1 Z. Prokuror.

2 Z. CARNEY: Jo, i nderuar Gjykatës. Ne këto parashtime  
3 kishim në lidhje me këto çështje, nuk kemi të tjera.

4 GJYKATËSI GUILLOU: Von Bone.

5 Z. VON BONE: E vetmja gjë që desha të përmend është që  
6 është mirë që të kemi një kalendar në mënyrë që të kemi parasysh  
7 se cilat data do të na duhet të jemi të disponueshëm. Kjo do të  
8 ishte e dobishme.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Unë informoj të dy palët që do të nxjerr  
10 një vendim për gjuhën që do të përdoret në këto procedura.

11 Mbrojtja nuk ka ndonjë vërejtje për këtë?

12 Z. VON BONE: Gjuha e punës është në rregull i nderuar  
13 Gjykatës.

14 GJYKATËSI GUILLOU: Po kështu do të nxjerr një vendim në  
15 lidhje me pjesëmarrjen e viktimave, sidomos për sa i përket  
16 procesit të aplikimit. Dhe një vendim kornizë për sa i përket  
17 detyrimeve të Prokurorit të Specializuar në lidhje me rregullën  
18 102, që do të përcaktojë edhe praktikën e redaktimeve për këtë  
19 procedurë.

20 Po kështu, dua t'i kërkoj palëve tani të na japin idetë e  
21 tyre për datat e përshtatshme për Konferencën e Ecurisë së  
22 Çështjes në të ardhmen.

23 Unë kam ndërmend, ose është objektivi im që ta caktoj datën  
24 menjëherë pas kësaj seancë, ose më mirë, pas seancës në të cilën  
25 i akuzuari do të vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë.



1 Z. CARNEY: Ne si Prokurori, nuk kemi ndonjë koment për  
2 këtë. Kur të jetë konveniente për Gjykatën.

3 GJYKATËSI GUILLOU: Mbrojtja?

4 Z. VON BONE: Nuk e di se cila është data në të cilën është  
5 parashikuar të vetëdeklarohet i akuzuari.

6 Për sa i përket disponueshmërisë time, unë kam datat 15 dhe  
7 20 tetor në të cilat nuk mund të paraqitem.

8 GJYKATËSI GUILLOU: Atëherë do t'i shmangim këto data, 15  
9 dhe 20 tetor.

10 Ftoj palët të bëjnë parashtrime me shkrim në qoftë se duan  
11 të ngrenë ndonjë çështje specifike gjatë Konferencës së ardhshme  
12 për Ecurinë e Çështjes.

13 Me kaq mbyllet seanca e sotme.

14 Falënderoj përkthyesit, stenografët, teknikët dhe personelin  
15 e sigurisë për ndihmën e tyre.

16 Seanca do të shtyhet për 10 minuta. Ne pastaj do të hyjmë në  
17 seancë të mbyllur për pjesën e dytë të kësaj Konference për  
18 Ecurinë e Çështjes Gjyqësore. Faleminderit.

19 --- Seanca përfundon në orën 15.53

20

21

22

23

24

25